


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 114, datë 24.12.2024

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM (PBA) PËR VITET 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive Të Vetëqeverisjes Vendore” dhe sipas Relacionit të përgatitur nga Sektori i Analizës së Statistikave dhe Planifikimit Afatmesëm në Drejtorinë e Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,



**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për vitet 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor si më poshtë :

Aktivitetet për hartimin e PBA-së	Afatet për vitin 2025
Paraqet për shqyrtim dhe miratim në K.B, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave në bazë të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave për: -dy vitet para vitit buxhetor (2023 dhe 2024) -vitin buxhetor 2025	Deri me 31 Janar

-tre vitet e ardhshme buxhetore (2026-2028)	
Miraton në K.B, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.	Deri me 1 Mars
Përgatit dhe paraqet në K.B, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel Programi.	Mars
Miraton në K.B, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Brenda 15 Marsit
Pas miratimit të tavanëve përgatitore të shpenzimeve, miraton Udhëzimin e Brendshëm të përgatitjes së buxhetit të NJQV dhe e shpërmdan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Prgramit (DEMP).	Deri në 20 Mars
DEMP,paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit te koordinatori i GMS.	Brenda muajit Prill
Dërgon projekt dokumentin e PBA-së, në M.F. (dy formularet Nr.1 dhe Nr.2 për parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve) të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar (IPF).	Deri në 1 Qershor
M.F. analizon dhe dërgon zyrtarisht raportin me rekomandime mbi projekt-dokumentin e PBA-së për çdo NjQV	Deri në 20 Qershor
Kryetari i NjQV, organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-s	Qershor
Këshilli i NjQV, mund të zhvilloj konsultime me publikun në fazën e parë dhe strategjike të përgatitjes së PBA-së si dhe në fazën e dytë, sipas kalendarit të përgatitjes së PBA-së.	Qershor
Dërgon për miratim në K.B, projekt dokumentin e parë të PBA të miratuar nga GMS për çdo NjQV, bashkë me raportin me rekomandime të M.F dhe Ekonomisë, i cili shqyrton dhe miraton këtë projekt dokument.	Deri në 30 Qershor
Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së së miratuar.	Deri në 5 Korrik
Përgatit dhe miraton në K.B, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së, në nivel programi sipas udhëzimit plotësues të MF.	Deri në 20 Korrik
Kryetari, shpërmdan Udhëzimin plotësues të përgatitjes se PBA-së, në Njësitë Shpenzuese.	Deri në 25 korrik
Përgatitet projekti i rishikuar i PBA-së.	Gusht
Publikimi i dokumentit të PBA-së të rishikuar.	Gusht



Organizimi i Seancave Dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit, ku mbahen proces- verbalet e takimeve së bashku me qendrimet përkatëse të NjQV që bëhen pjesë dokumentit të projektit të PBA-së.	Deri në 31 Gusht
Miraton në KB, dokumentin e PBA-së të rishikuar.	Shtator
Dërgimi në MF të dokumentit të PBA-së të rishikuar dhe të miratuar në K.B, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MF në fazën e parë.	Deri në 15 Shtator
Përgatit projekt- buxhetin vjetor, pas miratimit të PBA-së të rishikuar.	Deri 30 Shtator
Përgatit projektin e PBA-së përfundimtare dhe projekt-buxhetin vjetor, duke reflektuar rekomandimet përfundimtare të MF.	Tetor
Paraqet projektin e PBA-së përfundimtare dhe buxhetin vjetor për shqyrtim dhe miratim në K.B të NjQV.	Deri në 30 Nëntor
Miratimi në K.B i PBA-së përfundimtare.	25 Dhjetor
Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre.	Deri në 31 Dhjetor
Dërgon dokumentin e plotë të PBA-së në M.F, 15 ditë pas miratimit në K.B dhe publikimit të PBA-së.	Deri 15 Janar

2. Ngarkohen të gjithë Drejtoritë, Ndërmarrjet dhe Institucionet në varësi të Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.12.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 768 / prot.
3

Durrës, më 31 .12 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.114 datë 24.12.2024 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (pba) për vitet 2026-2028 dhe buxhetit vjetor”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

